REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË

Kryetari i Komunës
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
01-Nr-016-54264
Datë: 29.10.2026

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 42 paragraf 2 pika 2.3 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197 nenin 12 paragraf 5 pika 5.3 si dhe neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.07/2025 për procedurën e pranimit në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari Komunës bënë këtë :

SHPALLJE PUBLIKE

I. **Për angazhimin e profesorit dhe një zëvendësues, për të qenë pjesë e Komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të kandidatëve për konkurset në pranim,** Profesor i fushës (Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinieri Strukturore, Inxhinieri arkitekturore, Inxhinieri gjeoteknike, hidroteknik)

II. **Lokacioni vendi i punës Komuna e Suharekës.**

III. **Pagesa fikse është: 250 Euro për profesorin e angazhuar e cila paguhet për procedurën (grupin) e konkurimit.**

IV. **Mandati do të jet dy (2) vjeqar.**

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Profesori do të jet anëtar i komisionit për pranim në shërbimin civil dhe do të kryej detyrat e tij ashtu si janë përcaktuar në rregulloren (QRK) Nr.07/2025 për procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197.

Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Diplomë universitare në fushën : Profesor i fushës (Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinieri Strukturore, Inxhinieri arkitekturore, Inxhinieri gjeoteknike, hidroteknik) me të paktën 240 kredi.
- Kontrata ose vërtetim që dëshmon marrëdhënjen e punës.
- Për personat qe kanë diplomuar jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës nga MASHT-i.
- Së paku 5 vite përvoje pune pas diplomimit, në fushën profesionale.
- Të mos jenë të emëruar politik.
- Të mos jenë shërbyes civil.
- Të ket inegritet moral dhe profesional.
- Të mos jet i larguar nga sherbimi civil si rrjedhoj e masave diciplinore dhe të mos ket mas diciplinore në fuqi.
- Të drejtë konkurimi kanë kandidat nga shkollat apo universitetet e fushës.

Angazhimi në cilësinë e profesorit nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Komunën e Suharekës, mirëpo profesori do të angazhohet për një periudhë të caktuar kohore.

Mënyra e aplikimit:
Kandidatet e interesuar duhet të paraqesin këto dokumente:

- Një CV.
- Kopjen e letërnjoftimi.
- Dëshmi për shkollimin fotokopje e diplomes e vertetuar te noteri.
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Dëshmi që nuk është nën hetime.
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatët që aplikon.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 5 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës, prej datë 30.10.2026 deri më 03.11.2026.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret sipas shpalljës nuk do të kontaktohen.
Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë , duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen si dhe kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ